



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MAT

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

në kuadër të implementimit të projektit “MAT YESi , “More Alternatives Toward Youths Education and Social-economic Integration”

Në mbështetje dhe në zbatim të Nenit 64/a e vijues, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, si dhe të kontratës IPA/2021/425-824-“Më shumë Alternativa Drejt Arsimit të Rinjve dhe Integritit Social-Ekonomik-MAT-YESi” datë 12.08.2021 të lidhur ndërmjet Bashkisë Mat në cilësinë e “koordinatorit” dhe Bashkimit Evropian, Delegacioni në Shqipëri në cilësinë e “autoritetit kontraktues”, si dhe Vizion O.J.F. në cilësinë e “partnerit”, Bashkia e Mat shpall procedurat e konkurimit për vendin e lirë:

Financier projekti

I-Pozicioni financier projekti

a-Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me Menaxherin e Projektit për të siguruar menaxhim eficient dhe të qëndrueshëm të financave të Projektit.
- Financieri i Projektit do të bëjë ndjekjen e realizimit të projektit dhe të kontratave, si dhe siguron një procedim normal për të gjithë procedurat e pagesave nën këtë projekt, përfshi menaxhimin dhe plotësimin e të gjitha llogarive speciale dhe të sigurojë që kërkesat e BE për të gjithë aktivitetet të realizohen.
- Realizon një dokumentacion të plotë dhe menaxhimin të operacioneve financiare, nëpërmjet llogarive të përshtatshme dhe kontrolleve të brendshme.
- Përgatit pasqyrat financiare dhe raportet që lidhen me aspektin financiar.
- Sigurohet që transaksionet regjistrohen siç duhet dhe futen në sistemin e kontabilitetit.
- Siguron regjistrimin e saktë të transaksioneve në sistemin e kontabilitetit.
- Përgatit planifikimin financiar/buxhetor afat-shkurtër dhe afat-gjatë të projektit.
- Rishikon buxhetin e projektit sipas kërkesave të lindura.
- Bën rishikimin financiar të performancës së aktivitetëve të projektit.

b-Kualifikimet e domosdoshme

- Diplomë Universitare dhe Pasuniversitare në Fakultetin e Ekonomisë, Bachelor Dega “Financë” dhe Master në “Kontabilitet & Auditim”
- 5 vite eksperiencë pune në menaxhim buxheti dhe të ardhurash
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe organizimi.
- Aftësi të mira komunikimi, prirje për të punuar në grup dhe për të realizuar objektivat saktë dhe në kohe.
- Aftësi të menaxhimit dhënies së prioriteteve të detyrave të ndryshme .
- Aftësi shumë të mira organizuese kjo fale eksperiencave të fituara nëpërmjet kontakteve dhe punës në grup.
- Aftësi të mira kompjuterike, njohje e mirë e paketës Office e Microsoft Word, Microsoft Excel, Power Point .
- Gjuhë angleze dhe italiane me vlerësimin shumë mirë.

c- Aftësi të tjera

- Person me aftësi të mira komunikimi dhe organizative.
- Integritet
- I gatshëm të punojë në grup
- Inovator

d- Orari i punës

- 20 orë në javë

e- Paga

- Paga do të jetë 547,200 lekë bruto në vit

f- Dokumentacioni

- Një letër interesi
- Një CV

Dokumentacioni do të dorëzohet personalisht nga kandidatët pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Bashkia Mat.

g- Procedura e përzgjedhjes dhe shpalljet së kandidatit fitues

- Kandidatët të cilët kanë shprehur interes për këtë pozicion pune do të përzgjidhen nga Komisioni i Posaçëm i ngritur për këtë procedurë konkurrimi.
- Shpallja e fituesit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Mat.

h- Afati i dorëzimit të dokumentacionit

- Afati për dorëzimin e dokumentacionit do të jetë deri në datën 20.09.2021, ora 15:00.